

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29 JANAR 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 24

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 24

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëdita të gjithëve fillojmë mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak rendi i ditës është shpërndarë. Kush është dakort me rendin e ditës?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS DATËS 26 DHJETOR 2025”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem këshilltarëve të votojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1- 31 DHJETOR 2025”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka disa materiale nga komisioni i çështjeve sociale, strehimit dhe rinisë, në emër të komisionit do flasë dikush. Meqënëse komisioni nuk është mbledhur fjala për Administratën.

Ekzekutivi A.Vranishti: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.) Për të punuar, kryefamiljar femra me fëmijë të mitur, familje të komunitetit rom dhe egjiptian me probleme social-ekonomike. Për gjithë këto arsye ftojme Këshillin ta miratojë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët, nëse jo, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE, SIPAS VKM NR.835, DATË 30.12.2025 “PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR VITIN 2025”, PËR 12 FAMILJE TË NDIHMËS EKONOMIKE”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ekzekutivi ju lutem.

Ekzekutivi A.Vranishti: Mbi dhënien e mbështetjes sipas vkm-së nr.835, për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025, përfitojnë 12 familje të ndihmës ekonomike në masën 15 mijë lekë për secilën familje me një fond prej 180 mijë lekë. Familjet përfituese e trajtuara me pagesë në borderonë e vitit 2025, e kemi futur këtë material këtë muaj pasi vkm-ja ka dalë në datën 30 dhjetor dhe mbledhja e fundit ishte në datën 26 dhe nuk kishim mundësi dhe ishim të detyruar ta futim këtë muaj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E rëndësishme është që u fut. Ju lutem këshilltarëve të votojnë, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, ME 6 % NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR VITIN 2026.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Ekzekutivi A.Vranishti: Mbi miratimin e kriterëve që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me 6 % e fondit të kushtëzuar, këto kritere janë bazuar në ligjin 57 të vitit 2019 për asistencë sociale në Republikën e Shqipërisë dhe në vkm 597 për kriteret e procedurave të aplikimit për ndihmë ekonomike. Kriteret është detyrim ligjor të miratohen çdo fillim viti dhe pastaj të bëhet trajtimi i familjeve për vitin 2026. Kriteret janë të listuara dhe janë të bazuara në vkm dhe në ligj dhe ftojmë Këshillin Bashkiak për ta miratuar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Kisha dy pyetje, nuk po shoh në përfituesit mbase mbulojnë ndonjë skemë tjetër nuk e di, për familjet që kanë persona me aftësi të kufizuara, ose një kategori tjetër që kemi pasur në Këshill, familje që kanë persona me probleme të autizimit, a përfitojnë këta apo jo?

E dyta a është patjetër detyrim që të kenë aplikuar për ndihmë ekonomike apo mund të jenë edhe familje të tjera që evidentohen nga struktura juaj apo referohen nga shërbimi shëndetësor, parësor?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje të tjera?

Nëse jo fjala për ekzekutivin.

Ekzekutivi A.Vranishti: Familjet që kanë persona me sindromën daun ose autizëm, patjetër kanë të drejtë të aplikohen dhe kualifikohen në sistemin e pikëzimit. Këto janë dy sisteme të tjera që kualifikojnë kategori të veçanta të tjera familjesh me ndihmë ekonomike. Ndërsa këto kategori kualifikohen automatikisht në sistemin e pikëzimit, përsa i përket pyetjes të dytë kanë të drejtë edhe ata nëse kualifikohen në sistemin e pikëzimit përfitojnë direkt. Nëse nuk kualifikohen sipas kriterëve dhe sipas vlerësimit që bën administrator, kualifikohen në këto dy programe të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, hap procesin e votimit. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR VITIN 2026”.

Ekzekutivi A.Vranishti: Edhe kriteret për familjet në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, në ligjin 57 në Republikën e Shqipërisë 597 datë 4.9.2019 kriteret janë të listuara, ftoj Këshillin Bashkiak për ta miratuar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët, nëse jo, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse komisioni nuk është mbledhur, ju lutem ekzekutivi.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Duke qënë se në sistemin online të strehimit, nëpërmjet portalit unik E-Albania rezultojnë edhe 4 familje që kanë plotësuar kriteret dhe gjithë dokumentacionin ne i kemi sjellë Këshillit Bashkiak për miratim mbështetjen me bonus, këto 4 familjet janë kryesisht kategoritë prioritare të cilat i kemi sqaruar dhe në material dhe miratimin me vendim të Këshillit Bashkiak, bonusi, mbështetja financiare e tyre fillon prej datës 1 shkurt.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët, nëse jo, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Në emër të komisionit të financave ju lutem, znj.Përmeti.

Këshilltar A.Përmeti: Komisioni u mbledh ditën e henë dhe në lidhje me miratimin e fondit publik të banesave sociale dhe përdorimin e tij në buxhetin e vitit 2026, vlera e sjellë nga ekzekutivi është 26 milion lekë të reja, i cilit shtohet sipas programit dhe produktit të detajuar. Në relacionin e sjellë është shpjeguar dhe nga vjen kjo vlerë, bëhet fjalë për gjitha objektet që kanë leje ndërtimi mbi 2000 m2, 3% e saj do jetë kontribut për pjesën e detyrueshme nga subjekti për fondin publik të banesave e cila sipas kontratës mund të jetë në vlerë banese ose vlerë monetare, kjo është në varësi të kontratës të bërë me subjektin përkatës. Në këtë rast e sjellë dhe nga relacioni 26 milion lekë të reja do i kalojnë këtij fondi për këtë qëllim. Komisioni e trajtoi dhe e kalon për miratim në Këshill.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Unë u nisa me komisionin e mirëqënies sociale meqënëse jeni dy komisione bashkë. Megjithatë ka pyetje nga Këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Dy pyetje të lutem. 3 % e këtyre firmave e vendosin ata nëse e japin në natyrë me hyrje apo në fond monetar, apo e vendos Bashkia?

Këtu në material thuhet që kjo shumë që pritet të shtohet për vitin 2026 do vihet në përdorim për shtimin e banesave sociale, kemi ndonjë plan, do bëhet ndonjë ndërtim i ri, sa do ndërtohet, ku do ndërtohet?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje të tjera?

Këshilltare M.Qelesh: Kisha diçka këtu në raportin e KLSH-së që i përket viteve të kaluar, është lënë një rekomandim dhe thuhet, nga ana e drejtorisë të planifikimit të territorit nga ana e Drejtorisë Juridike , të merren të gjitha masat, për të indentifikuar të gjitha rastet që janë subjekt i kontributit që sektori privat duhet t'i japë fondit publik për strehimin social që në fazën e shqyrtimit të aplikimit të pajisjes me leje ndërtimi të njoftojë zhvilluesit të lidhin akt marrëveshjen, para miratimit të lejes të ndërtimit. Për këtë periudhë që është bërë materiali, është marrë parasysht rekomandimi i KLSH-së që është lënë tani në fund?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje të tjera?

Atëherë një përgjigje nga drejtorja e strehimit dhe nga drejtorja juridike.

Drejtorja Juridike A.Qermaixhi.Dishnica: Paraprakisht dua të shpjegoj pak procedurën si ecim ne kur një subjekt detyrohet të paguajë fondin prej 3 % . Për lejen e ndërtimit Bashkia lidh një kontratë

me subjektin ndërtues ku parashikon edhe mënyrën sesi do e shlyejë detyrimin që ka ndaj Bashkisë, nëse ky detyrim do shlyhet në vlerë leku, apo në objektin që po ndërton apo në natyrën e një objekti tjetër, nuk është detyrim që ne e vendosim do e shlyesh në nivel leku, ne përcaktojmë në marrëveshje me investitorin mënyrën sesi do shlyhet, nuk parashikojmë një vlerë në fillim por para se të pajiset me lejen e shfrytëzimit, bën ekzekutivin dhe detyrimin, pastaj pajiset me çertifikatë përdorimi. Për rekomandimet e KLSH-së janë zbatuar të gjitha. Nuk ka asnjë subjekt i cili të ketë pasur detyrime ndaj Bashkisë dhe mos jetë nënshkruar marrëveshja.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Një sqarim nga kryetari.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne patjetër me KLSH dhe grupet e auditimit e kemi diskutuar këtë pikë dhe kemi pranuar ato rekomandime që i vlejné punës, në mos gaboj një rekomandim ka qënë që ta përcaktonim që në fillim se cila do ishte sipërfaqja konkrete që ne do merrnim edhe këtë besoj do e zbatojmë për sa kohë mund të zbatohet. Përsa i takon përdorimit të këtij fondi ne kemi një fond të grumbulluar në masën 48 milion lekë ndërkohë që parashikimi për këtë vit është 26 milion, diku në total do jenë 74 milion të reja. Koha e përdorimit do jetë sipas përdorimit ligjor, në funksion të strehimit social do diskutojmë dhe do vendosim bashkë me drejtorinë e strehimit social se çfarë projekti konkret do financojmë me gjasa, ka mundësi të financojmë ndërtimin e një banese me qira sociale, me përdorimin e këtij fondi do zbatojmë atë që është kriteri ligjor për çfarë mund të përdoret fondet që krjohen nga detyrimi i 3 % që është detyrim ligjor.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar. Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2027-2029.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Në emër të komisionit të financave znj.Përmeti.

Këshilltare A.Përmeti: Edhe këtë pikë komisioni e shqyrtoi, u dëgjua dhe nga ekzekutivi si u bë parashikimi e keni dhe në material, parashikimi është bazuar në pjesën edhe të historikut por edhe të asaj se çfarë Bashkia parashikon të mbledhë duke dhënë edhe gjithë pjesën teknike që ka dhe bashkëpunimet të ndryshme , në mënyrë që të vjelë sa më shumë të ardhura në pjesën e tarifave dhe taksave. Gjithashtu duhet theksuar që parashikimi që bëhet për 3 vite është afërsisht në vlerën 1 %, kjo ka qënë edhe vitin e kaluar. Gjatë komisionit u bënë edhe pyetje në lidhje me realizimin që ka qënë më pak vitet e kaluara dhe pse vazhdon përsëri i njëjti parashikim. Për këtë mund të na thotë edhe ekzekutivi në lidhje me taksat që vijnë sidomos nga taksa e ndërtesës. Ndërkohë që ne

si komisioni folëm , parashikimi bazohet edhe në pjesën se çfarë Bashkia ka, të regjistruar në pjesën e tokave, ndërtesave dhe kjo bëhet me pjesën totale që është, pavarisht sesi lidhet kjo takes. U vlerësua dhe pjesa që lidhet me përjashtimet që janë parashikuar, grupet të cilat përjashtohen. E rëndësishme është dhe pjesa e favorizimit që ka të bëjë edhe me pjesën e bizneseve, ku janë përfshirë dy kategori për përjashtim nga taksat vendore, për gratë e moshës 19-30 vjet të cilat ushtrojnë për here të parë aktivitetin në fushën e artizanatit, gjithashtu edhe për vitin 2026 dhe atë pasardhës, gjitha subjektet që do rregjistrohen nga gratë viktime të dhunës në familje të cilat janë të pajisura me vendim gjykate ose urdhër mbrojtjeje. Kemi shtim edhe subjekte të cilat në varësi të punësimit kanë ulje të tarifave vendore, gjithashtu edhe familjet që janë me kategori të caktuara, sidomos për pensionistë të vetmuar , apo edhe për grupet e tjera që përjashtohen nga tarifatat gjelbërim, ndriçim edhe kjo është si bazë në bazë të planit që kemi vendosur ne në fund të vitit, mendojmë ta kalojmë për votim dhe më pas do përcaktojmë edhe pjesa e caktimit të tavanëve buxhetor do përcaktojmë më pas edhe pjesën e shpenzimeve që vjen më vonë në një seancë tjetër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit ka diçka nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 4

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 23 pro, 1 kundër, 4 abstenim.

Pika 10 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “ SHËRBBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Në emër të komisionit të financave znj.Përmeti.

Këshilltare A.Përmeti: Edhe këtë pikë komisioni e shqyrtoi, bëhet fjalë për një të ardhur shtesë në që i shtohet buxhetit e cila vjen si fond nga Këshilli i Qarkut Korçë me një fond të përcaktuar që shkon për moshat e treta, bëhet fjalë për shtimin e një punojësi social në qendrën në lagjen 8 pasi numri i të moshuarve që ka nevojë për shërbim social është rritur, bëhet fjalë jo për shërbimin në qendrat komunitare por në shtëpi. Ne ishim edhe në një takim që realizoi Këshilli i Qarkut për aktivitetet që janë në ndihmë të të moshuarve dhe kur dëgjonim të moshuarit të vlerësonin këtë nismë që Këshilli i Qarkut ka 3 vjet që e ka ndërmarë dhe ne shkojmë i ndihmojmë qoftë me ushqime, apo ndonjë document dhe ata e vlerësonin me lot në sy dhe është gjëja më minimale që mund të bëjmë ne dhe duhet një duartrokitje e madhe për atë që ka bërë projektin dhe Bashkia Korçë është përparimtar për këtë me ato që kam parë ne terren me Bashkitë e tjera. Shpresoj ta vazhdojmë dhe ftoj Këshillin ta miratojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar A.Zheku: A është bërë një analizë nga drejtoria përkatëse dhe pse është zgjedhur në lagjen 8 dhe jo në lagjen 10, se mbase do kishte nevojë edhe në lagjet e tjera me shtimin e moshës të tretë ka nevojë vërtet për t'i asistuar. Çfarë shërbime të tjera janë shtuar përpos kësaj kategorie të ndjeshme të moshës të tretë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Para se t'i jap fjalës znj.Përmeti, dua të them që që na viti 2016 këto qendra janë rritur dhe gjej rastin të falenderoj Këshillin e Qarkut që vendosi ta zgjerojë këtë game të projekteve të shërbimeve siç është kjo e shërbimit në familje, jo vetëm në qendra. Mbase në të ardhmen do të duhet që të ketë qendra të tjera por kjo me të parë sa do jenë frekuentuesit e moshës të tretë.

Këshilltare A.Përmeti: Mbase përgjigjet ekzekutivi, por ne atë ditë u informuam që ka 4 qendra për moshën e tretë dhe dy janë për familjet. Ky projekt lidhet përveç punojësve që ndodhen aty, janë edhe punojësit që dalin në terren, vlerësimi ka erdhur nga Këshilli i Qarkut i cili merret me projektin. Ne si Bashki fondi që na vjen e miratojmë me këtë destinacion .

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje të tjera?

Këshilltar K.Pllaha: Unë e kam ndjekur këtë kategori që kur e kishte Këshilli i Qarkut dhe e përgëzoj si projekt sepse është një kategori e cila vërtet po shtohet. Këtë procedurë bën Bashkia, Dorcas, Kenedi dhe më lejoni të sygjeroj që duhet një kordinim i gjitha këtyre përpjekjeve për të maksimizuar sa më shumë këtë shërbim që u ofrohet të moshuarve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dy fjalë për projektin që mos krijojmë konfuzione , është një projekt i përbashkët që bashkëfinancohet nga Bashkia dhe Fondacioni Dorcas. Bashkia paguante kosto operacionale qera, dritë, ujë. Dorcas mbështeste punojësit, stafin dhe aktivitetet. Në një moment të mëvonshëm në kohë për shkak të ndryshimit të politikave që mbështesnin Dorcasin, burimet e financimit të tyre u ndërpreën dhe në këtë moment hyn në lojë Këshilli i Qarkut, i kemi kërkuar atë që financonte Dorcasi, stafin dhe organizimin e eventeve dhe që në atë moment Këshilli i Qarkut ka qënë partner me Bashkinë. Më vonë para dy vitesh Këshilli i Qarkut bëri një studim mbi bazën e këtij projektit qendra komunitare për moshën e tretë sesi ky projekt të zgjerohet nëpërmjet ofrimit të shërbimit në familje për një kategori nga përfituesit e këtyre qendrave që ishi pensionistët e vetmuar për shërbime, asistencë shëndetësore, bërja e pazarit, është bërë një evidentim në teren për numrin e përfituesit të këtij projekti dhe tani jemi duke parë mundësitë sesi projekti të zgjerohet për të ofruar shërbim edhe në familje, është e vërtë që krahas këtij projekti ka edhe fondacione që operojnë në teren, Fondacioni Kenedi që po bën një punë të admirueshme. Është e vërtet ju kam kërkuar edhe unë donatorëve që duhet të ketë një lloj sinergjie midis aktorëve, mos përsëritim njëri- tjetrin dhe të shihet një mënyrë për tu integruar këto shërbime, ju kam sygjyeruar edhe përfaqësuesve të Ministrisë, apo të donatorëve të tjerë, të shihet një fondacion i sukseshëm dhe ne t'i bashkëngjitemi atij projekti të Kenedit për atë gamë shërbimesh që ofrojnë duke kontribuar financiarisht dhe nëpërmjet këtij fondi shtesë të zgjerojnë gamën e shërbimeve dhe numrit të përfituesit. Është një sfidë, një nga gjërat që e kam shqetësim instucional edhe personal, e kemi diskutuar edhe këtu në Këshill po rritet numri i individëve të moshuarve të vetmuar dhe kanë nevojë për shërbime dhe mbështetje dhe nevojat do jenë në rritje në vazhdim, edhe nevojat për të

adresuar këtë problematikë do jenë në rritje për të ardhmen. Çdo inicitivë është e mirëpritur, çdo lloj kontributi vlen për tu diskutuar dhe vlen për ta parë sesi duhet ta adresojmë. Një përpjekje tjetër është që e kemi filluar është zgjerimi i këtyre qendrave dhe përtej qytetit, kemi filluar me Bulgarecin dhe besoj se këtë vit do kem diçka të ngjashme edhe në Dvoran, do marrim me qera një ambient, ku këta të moshuarit të mblidhen atje bashkë, është një përpjekje e pamjaftueshme sigurisht akoma që ne të dalim përtej kufijve të qytetit edhe të shkojmë edhe tek njësitë administrative.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Besoj se e kemi të qartë, ta shtojmë këtë buxhet në buxhetin e Bashkisë Korçë nga Këshilli i Qarkut i cili do adresohet vetëm për këtë projekt. Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 29 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

“ PËRMIRATIMIN E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM FINANCI MI TË HUAJ NË VLERËN 1.111.093.19 LEKË”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare A.Përmeti: Edhe për këtë pikë u diskutua në komision në lidhje me grandin bazuar në performancë, bëhet fjalë për vlerën 2 milion e 9 mijë 69. 59 lekë, nga të cilat 1 milion e 11 093.19 janë burime financimi të huaj dhe bëhet fjalë për Qeverinë Zviceriane dhe Suedeze dhe pjesa tjetër 898 876.4 është fond nga Qeveria Shqiptare që do jetë nëpërmjet transfertës të pakushtëzuar. Duke qënë se donatori kërkon paraprakisht miratimin në Këshillin Bashkiak dhe detajimin se ku do shkojë paraprakisht ky grand është sjellë për miratim në Këshillin Bashkiak që ky fond do përdoret edhe në ndërhyrje për mirëmbajtje e Biblotekës “Thimi Mitko” dhe në muzeun “Gjon Milli” duke shtuar zërin e programit af 122 me këtë vlerë në material. Ne nuk kishin diçka tjetër, pasi u informuam besoj ta kalojmë në votim sepse është një shtesë që i bëhet buxhetit dhe që shkon përsëri në shërbime që i ofrohen publikut.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Pyetja e parë ka të bëjë me faktin, ky është një financim për investim, apo do përdoret edhe për mirëmbajtje?

E dyta, a ka një vlerësim të këtyre objekteve që do ndërhyet për mirëmbajtje ristaurimi, apo diçka tjetër, si është marrë ky vendim?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Petri ka kërkuar fjalën.

Këshilltar L.Petri: Dua të pyes, cilat ishin kriteret që u përzgjedhën këto drejtime financimi?

Duhej shteruese për të parë se ku do bashkëfinancojmë nga ana e ekzekutivit?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka ndonjë shpjegim nga ekzekutivi?

Këshilltare A.Përmeti: Pyetjes të parë mund t'i përgjigjem edhe unë. Ky fond do shkojë për shpenzime operative dhe investime, pastaj e zgjedh Bashkia nëse do bëjë shpenzime apo investime. Përjashtohet fondi për paga, sigurime shoqërore dhe shpërblime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rastin konkret nga pikëpamja e financës konsiderohet investim. Vlera është llogaritur duke hartuar një prevertiv për ndërhyrjet në dy raste nga ana e drejtorisë të urbanistikës dhe bazuar në këtë prevetiv është përputhur financimi me prevetivin. Si u bë përziejdhja, këto janë disa ndërhyrje që në çdo lloj rasti do duhet t'i financojmë, në rast se nuk na vinte kjo shtesë do parashikonim një vlerë në buxhet, janë ndërhyrje që duhet t'i realizojmë, sepse duhen bërë në këto moment problematikat që janë konstatuar me këto dy problematika.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar E. Bregu: Në lidhje me këto ndërhyrje kërkova nëse është bërë një vlerësim ashtu siç edhe ju miratoni që është bërë një vlerësim me procesverbal, me prevetiv dhe do doja që ne t'i kishim prevetiv. Pse nuk na keni sjellë? Duhet të ishte bashkëngjitur me dokumentin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E para të fitohet grandit.

Këshilltar E.Bregu: Përderisa është bërë vlerësimi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Prevetivin e kemi ja u japim, nuk e di si e keni pasur taktikë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk e kemi pasur taktikë, thjesht e kemi miratuar fondin që vjen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk është se Këshilli do shikojë sa m2.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Megjithatë ekziston nuk është se ne po shkojmë atje në terren dhe po bëjmë teknikën.

Këshilltar K.Pllaha: Sipas kriterëve të grantit të performancës i takon Këshillit Bashkiak që të vendosë se ku do adresohen këto fonde që vijnë nëpërmjet këtij grandit, por do ishte pozitive sikur të na ishte marrë mendimi ne si Këshill, para se të vinte ky propozim. Nëse më lejohet të jap mendimin personal, nëqoftëse në kriteret e grandit një nga pikat që ka më shumë peshë është mbarështimi i fondit pyjor, për mua do ishte me interes që ky fond të dedikohej vetëm për këtë çështje të cilën është e nevojshme në Bashkinë Korçë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që Këshilli është autoriteti që miraton përdorimin grandit të performancës, ndaj edhe e kemi sjellë në Këshill por nuk mund të vijë tani si një letër e hapur kemi këtë fondin edhe të mbledhim diskutime, nuk është kështu. Nga ana tjetër ndërhyrjet që kemi propozuar në çdo rast do duhet t'i realizonim në mos me këtë fond me buxhetin e Bashkisë. Përsa i takon hartimit të mbarështimit të ekonomive pyjore në buxhetin e Bashkisë, nuk e kemi drejtorin e drejtorisë pyjore sepse nuk ka qënë por në mbledhjen e rradhës mund të japim një shpjegim se

deri ku jemi me rregjistrimin ekonomive pyjore dhe me hartimin e planeve të mbarështrimit. Për ekonominë pyjore të cilat ne i shfrytëzojmë me kontratë kemi planin e mbarështrimit të miratuar. Mund të japim një informacion mbledhjen e rradhës sa ekonomi kemi, sa e kemi planin, për sa jemi në proces.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Jemi tek komentet apo pyetjet?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Tani i mbaruam pyetjet, jemi tek komentet.

Këshilltar L.Petri: Nga përgjigjia që mu dha nga ekzekutivi unë e kuptova se i mungon një matricë e shkallëzimit se ku janë nevojat për tu investuar në rast se ka mundësi për bashkë financim edhe zuri qeni një lepur edhe po e japim këtu. Unë jam i vetëdijshëm që ka nevojë për investime në infrastrukturë si për Bibliotekën “Thimi Mitko” si për Muzen por kujtoj se të dyja këto institucione arketojnë të ardhura, buxhetohen nga Këshilli i Bashkisë dhe mendoj që duhet treguar më shumë vëmendje ku mund të drejtohen këto financime. Fjala vjen ne kemi një fotograf shumë të shquar që është Sotiri ku ka nevojë për mbështetje qoftë në konceptin e muzealizimit, qoftë në çeljen e fondit që në të ardhmen mund të bëhet tek ky muze. Fjala vjen ne kemi veprën e Asdrenit e cila është nën hije e kemi në kartmonedhat tona, por çfarë bëjmë ne që të lexojmë poezinë e tij dhe dhembshurinë e tij sot?

Janë e shumë të tjera por nuk dua të lodh kokën me një listë të gjatë, por do sygjeroja të bëhej me proaktive nëse do kishim nevojë për ide të jeni më të vëmendshëm në drejtimin e këtyre financimeve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Pra nuk e përjashtoni rastin që ka nevojë për investime, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pa dashur të rokanisim kokën e njëri-tjetrit nuk e di ku e gjete këtë zuri qeni një lepur, patjetër investimet e Bashkisë orientohen sipas nevojave të Bashkisë, që kemi prioritarizuar së bashku, ju e dini që ne kemi një listë të investimeve të miratuara, nuk është se ecim kuturu. Nga ana tjetër ka nevoja që dalin gjatë vitit dhe që duan adresim të menjëhershëm, thënë këtë se po bëjmë këtë projekt dhe nuk besoj se ju sygjeroni që ne duhet të lejojmë degradimin e objekteve që i kemi ekzistuese, duke shtuar objekte të tjera. Si mendoni ju duhet të investojmë tek projektet e reja dhe të lemë ato ekzistuese?

Edhe retorike e kam, janë objekte të rëndësishme të qytetit që kanë shfaqur problematikë gjatë shirave të fundit dhe që duhen adresuar në mënyrë të menjëhershme dhe mos degradojnë, Kjo nuk do të thotë se nuk kemi vëmendje për investime të tjera. Diçka për Asdrenin ju e dini ose në rast se nuk e dini do e mësoni tani. Fondi Shqiptar i Zhvillimit po investon në rikualifikimin e qendrës të fshatit Drenovë, pjesë e rikonstruksionit është edhe objektin në qendrën e fshatit ku ka qënë më para edhe muzeu i Asdrenit, në kuadrin e këtij rikualifikimi do shohim edhe mundësinë së bashku me personat e fushës sesi ta rikthejmë në funksion me një dimension të ri. Edhe për pjesën e Sotirit është një projekt që ja vlen të konsiderohet por unë mendoj që në rradhë të parë të kujdesemi të kemi në kushte optiamle objektet ekzistuese pastaj të shkojmë për të shtuar fondin e objekteve të reja.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 2 abstenim.

Pika 12 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse komisioni juridik nuk është mbledhur, ju lutem dikush nga ekzekutivi.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Plani vjetor i miratimit në shërbimin civil është një dokument që miratohet çdo vit në Këshillin e Bashkisë, për plotësimin e vendeve vakante pjesë e shërbimit civil dhe referuar strukturës 2026 numri i vendeve vakanteve pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Korçë janë 66. Nga këto vende një pozicion është për nënpunës të nivelit të lartë drejtues që është drejtor i drejtorisë të përgjithshme, 8 vende vende janë për nënpunës të nivelit të mesëm drejtues, drejtor drejtorie, 11 vende për nënpunës të nivelit të ulët drejtues, përgjegjës sektori dhe 46 pune për nënpunës të nivelit ekzekutiv, specialist. Pranimi në shërbimin civil bëhet nëpërmjet procedurës të konkursit dhe ata që rezultojnë fitues do emërohen. Përsa i përket drejtuesve të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët, plotësimi i këtyre vendeve bëhet nëpërmjet procedurës të lëvizjes paralele, nëse nuk nuk plotësohet nga procedura e lëvizjes paralele bëhet nga procedura e ngritjes në detyrë, nëse nuk plotësohet as nga plotësimi i kësaj procedure ligji parashikon që 20 % e këtyre vendeve mund të plotësohet nga jashtë shërbimit civil dhe për këtë arsye kemi propozuar që 4 nga këto pozicione të plotësohen nga jashtë shërbimit civil që janë drejtor i drejtorisë të turizmit, drejtor i drejtorisë të marrëdhënieve me publikun, përgjegjës sektori të turizmit dhe përgjegjës për kontrollin e zhvillimit të tokës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje?

Këshilltar A.Zheku: Plani vjetor i pranimit civil duhet të reflektojë vetëm nevojat reale, referuar nenit 18 të ligjit përkatës që është cituar edhe në material 152, a është bërë një analizë e detajuar për nevojat aktuale apo arsyet pse duhen këto, si janë mbuluar deri tani?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar K.Pllaha: Quhet lëvizje paralele apo ngritje në detyrë për stafin për stafin që është punësuar aktualisht me kontrata të përkohshme?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Jo sepse është me kontratë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka pyetje, një përgjigje nga ekzekutivi.

Këshilltare L.Alidinaj: Po shikoj këtu drejtor i drejtorisë të turizmit, drejtor i drejtorisë të marrëdhënieve me publikun, përgjegjës sektori të turizmit dhe përgjegjës për kontrollin e zhvillimit të tokës. Aktualisht këto 4 pozicione nga kush mbulohen sot, ka titullarë?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Përsa i përket analizës dua të sqaroj se ky është një plan që përfshin gjitha pozicionet që janë vakante në momentin e miratimit të strukturës, përsa i përket planit ky bëhet në momentin që shpallen këto pozicione në bazë të një kërkesë të detajuar dhe të analizuar nga drejtorja përkatëse, në plan parashikohen gjitha pozicionet që janë vakante. Përsa i përket kësaj pyetjeje nëse këta që janë me kontratë quhet lëvizje apo jo, nuk bëhet sepse duhet të jesh nënpunës civil, të kesh kaluar periudhën e provës, të kesh bërë testimin tek ASPA dhe pastaj të quhesh nënpunës dhe pastaj t'i nënshtrohesh procedurës të lëvizjes paralele. Drejtorin e turizmit dhe drejtorisë të marrëdhënieve me publikun i plotësojnë aktualisht kryetarët përkatës. Përgjegjesi i kontrollit e zhvillimit të tokës është në varësi të drejtorisë të planifikimit të territorit dhe mbulohet nga drejtori i kësaj drejtorie.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, nëse nuk ka diçka tjetër hap procesin e votimit. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 3

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 21 pro, 4 kundër, 3 abstenim.

Pika 13 e rendit të ditës.

“ MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET KONKURIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI DESTINACION TURISTIK”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse dhe këtu komisioni nuk është mbledhur një sqarim për këshilltarët nga ekzekutivi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ju e dini që turizmi është një sektor shumë i rëndësishëm i Bashkisë dhe ne jemi duke bërë përpjekjet për këtë sektor që të japë atë kontirubut që jep dhe të rritet në vazhdimësi. Mendoj se turizmi ka shumë potencial për tu ritur jo vetëm në Bashkinë Korçë por edhe në Qarkun Korçë, përpjekjet i kemi të shumta në këtë drejtim për të konsoliduar ato që kemi arritur por edhe për të hapur prespektiva të reja në sektorin e turizmit. Krahas angazhimit të stafëve dhe burimeve njerëzore të Bashkisë dhe mendoj të kemi përfshirje edhe të organizatave jo qeveritare që kanë eksperiencë që të bëhen pjesë e përpjekjes të përbashkët për të bërë një promovim më të mirë të potencialit turistik të Korçës por edhe për të bërë një menaxhim më të

mirë profesional në destinacionin turistik. Në këtë këndvështrim ju propozojmë një material e cila siç thashë do jetë pjesë bashkë me Bashkinë për të promovuar destinacionin e Korçës si destinacion turistik dhe paralelisht të bëjë edhe menaxhimin e zyrës ekzistuese të informacionit turistik, duke ja dhënë këtë ambient me huapërdorje. Unë dua shumë për të zhvilluar sektorin e turizmit, Bashkia të mos jetë e vetme, të jetë patjetër ata që janë më të ineteresuar se ne që ky biznes të zhvillohet që janë bizneset, operatorët turistik që operojnë në këtë sektor por edhe organizatat e ndryshme që kanë eksperiencën dhe dëshirën të japin kontributin e tyre, Kemi filluar eksperiencat e para duke i ftuar që të marrin pjesë në panairët kombëtare ose ndërkombëtare ku Bashkisë Korçë i mundësohet pjesëmarrja në stendën e Shqipërisë. Duam që këtë eksperiencë ta shtrijmë ta konsolidojmë edhe në të ardhmen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Pyetjen e kam në lidhje me qasjen që do ketë kjo strukturë, në parim janë 2 me aq sa kemi parë ose punon bota sot është Dmc ose Dmo. Unë jam në dijeni sepse kam qënë dhe vetë një nga pjesëmarrësit që kemi shkuar në Gjirokastër dhe ajo e bënte me DMC, është një kompani që duke promovuar turizmin synon dhe ngritjen e të ardhurave të veta, nëse është dmo këtu ka disa drejtime si mund të organizohet, shtete të ndryshme kanë modele të ndryshme. Por pyetja ime është kjo cili do jetë roli i Bashkisë Korçë?

Bashkia Korçë po synon të zgjedhë një kompani apo OJQ strukturë të jashtme dhe merret ajo nga A në zh dhe do vihen pikat mbi I nga Bashkia apo do ndiqet nga Bashkia. Si do jetë organigrama e këtij projekti? Cili do jetë derigjenti kryesor dhe nëse sigurohen të ardhurat për çfarë do shkojnë ato?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Unë jam shumë dakort që bashkia të bashkëpunojë me shoqëritë civile dhe t'i ketë ata bashkëpunorë qoftë edhe në fushën e turizmit. Nuk kuptova përveç godinës me huapërdorje që përdor kjo shoqatë, çfarë përfiton tjetër, i lind e drejta të jetë përfaqësues i Bashkisë në këto panaiere? A përfiton ndonjë projekt nga Bashkia për të promovuar turizmin apo thjesht do shfrytëzojë ambientin atje?

Në lidhje me dokumentin e mëparshëm që miratuar ju shtuat ose të paktën mendohet se do shtohet staf në sektorin e turizmit drejtoresh e përgjithshme, përgjegjës sektori, specialist. Mos është pak e tepruar tani që nga njëra anë shton staf dhe nga ana tjetër delegon përgjegjësi tek një organizatë civile, mbase është një kosto e dyfishtë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për kryetarin, pastaj znj. Ada Përmeti.

Këshilltare A.Përmeti: Kam një pyetje, pasi të përzgjidhet organizata jo qeveritare që do bëjë këtë gjë, do financohet totalisht nga Bashkia apo si do funksionojë kjo?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E tha Klajdi.

Këshilltare A.Përmeti: Unë e kam më shumë në pjesën e fondeve. Strukturat e Bashkisë unë i shoh se janë të nevojshme sepse mungesa e strukturës për një kohë të gjatë të sjell apati në mënyrën si do e menaxhosh. Sot ashtu siç tha dhe parafolësit është e nevojshme të bashkëpunosh me

organizatat dhe Korça ka nevojë t'i ketë të dyja dimensionet edhe ekzkeutivin në kontroll edhe në bashkëpunim por edhe organizatat të organizojnë aktorët e tjerë të zonës. Fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëherë ka dy momente materiali që na është shpërndarë, momenti i parë është përzgjedhja e një organizate që do bëjë menaxhimin e zyrës turistike të Bashkisë duke ja dhënë me huapërdorje. Në këtë moment pastaj ka një kuadër ligjor që jep atë bashkëpunimin ne ja japim me huapërdorje pa pagese dhe organizata pastaj duhet të mbulojë pjesën tjetër të menaxhimit të kësaj zyre të informacionit turistik. Momenti i dytë është prespektiva dhe mendoj se momenti i parë do shërbejë si bazë për momentin e dytë sesi bashkëpunojmë ne me operatorët private dhe organizatat jo qeveritare për të bërë atë që është menaxhimi i destinacionit turistik që bëhet vetëm nga Bashkia. Konstatoj se kemi një problematikë që një pjesë e operatorëve private konsiderohet sikur puna e tyre ka mbaruar në momentin kur ata realizojnë një investim në fushën e turizmit dhe pastaj presin që ecuria e biznesit të vijë ose nga zoti ose nga Bashkia ndërkohë që puna tyre në atë moment fillon, ti bën investimin dhe pastaj fillon gjithë përpjekjet që ky investim të vihet në punë. Përpjekjet duhet të jenë individuale por është shumë mirë që krahas pjesës individuale është dhe përpjekja e kordinuar që nuk e kemi shpikur ne por po e marrim si model nga destinacione të tjera të sukseshme të mirënjohura të turizmit të botë që bëjnë menaxhimin e destinacionit që bëjnë bashkë të gjithë aktorët publik, privatë dhe shoqërisë civile. Unë këtë hapin e parë të zyrës të informacionit turistik e shoh si hap të parë pastaj për të shkuar edhe në menaxhimin e një DMO-je pra në menaxhimin e një organizate të menaxhimit të destinacionit. Në dijeninë time ka një iniciativë nga Ministria përkatëse për të hartuar edhe kuadrin ligjor, një ligj për dmo në Shqipëri i cili besoj do verë në kornizë ligjore këtë mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet aktorë të ndryshëm, publik, privat dhe organizata jo qeveritare me detyrime edhe të drejtat e gjithësecilit. Unë e shoh që kjo përpjekje të jetë e sukseshme duhet që destinacioni të bashkëfinancohet nga një organizatë që të jetë entitet publik edhe privat, edhe Bashkia që kontribon edhe biznet private që edhe ata kontribojnë edhe shoqëria civile, organizatat që operojnë në këtë fushë kanë eksperiencë edhe mund të bëhet edhe menaxhimi. Jam shumë i gatshëm që Bashkia Korçë të japë kontributin e saj me burime njerëzore, me burime financiare që kjo punë të bëhet në më të mirën e mundshme dhe jo vetëm si Bashki por kjo punë të bëhet në më të mirën e mundshme dhe kjo organizatë minimalisht duhet të jetë në nivel të qarkut, vetëm ashtu mund të arrijmë një masë kritike të ofrimit të produkteve të ndryshme turistike të cilat të kombinuara me njëra-tjetrën bëjnë një ofertë turistike e cila është shumë e mirë. Në rast se kombinojmë potencialin turistik të gjithë Bashkive të Qarkut trashëgiminë kulturore, jetën e natës, eventet që ka Korça, bukuritë natyrore. Kemi një potencial që mund të jetë më i miri në nivel vendi, ajo që duhet të bëjmë që këtë potencial ta menaxhojmë dhe ta marketojmë në më të mirën e mundshme dhe në këtë përpjekje tërheqja e organizatave të shoqërisë civile është shumë e rëndësishme dhe unë jam shumë i vendosur ta bëj në të ardhmen, përtej shoqërisë civile që mos më kritikojë Suela edhe universiteti është shumë i rëndësishëm, kam bërë disa takime edhe me shefen e departamentit të turizmit dhe makretingut edhe me dekanen e re dhe mendoj që Bashkia, biznesi, shoqëria civile dhe universiteti duhet të jenë aktorët bazë që duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të adresuar gjithë problematikat edhe sfidat e turizmit me qëllim që sa më shpejt të marrim maksimumin që ky rajon meriton të marrë nga zhvillimi i turizmit në vendin tonë. Përsa i takon stafit ne për një periudhë të gjatë kohe kemi qënë në stafin e nevojshëm që do duhet të alokojmë për këtë sektor, ka qënë një nga kritikant që na janë bërë në mbledhjet e Këshillit me të drejtë besoj,

nga viti i kaluar kemi bërë një plotësim të këtij stafi por besoj se problematikat edhe nevojat kërkesat që ka sektori i turizmit kërkojnë kombinim të burimeve njerëzore të Bashkisë edhe të angazhimit të organizatave të biznesit, por nuk është se po përfshimë një organizatë duhet të reduktojmë staf të Bashkisë, besoj që jemi në optimumin që duhet të jemi me këto angazhime që kemi të stafit gjatë vitit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, z.Bregu ka kërkuar fjalën për diskutim, apo pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Për pyetje. Nuk e kuptova nëse Bashkia do financojë lekë për këtë projekt apo jo, lidhur me këtë shoqatë?

A e di Bashkia se sa shoqata janë në Qarkun Korçë që plotësojnë këto kritere në rang Qarku dhe plotësojnë kriterin për të marrë pjesë në konkurim?

Si është emri i shoqatës që është përzgjedhur për këtë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk është përzgjedhur.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kemi përzgjedhur ndonjë shoqatë sepse siç edhe e shihni në material jemi duke miratuar kriteret për të përzgjedhur një organizatë, nuk ka një listë të organizatave që plotësojnë këto kritere në Qarkun e Korçës por të gjitha organizatat janë të ftuara që në një formë ose në një tjetër që operojnë në fushën e turizmit të përfshihen dhe të bëhen pjesë e këtij grupi që po përpiqet t'i japë një dimension të ri zhvillimit të turizmit në Bashkinë e Korçës edhe në Qarkun e Korçës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Fejzullah ka kërkuar fjalën për pyetje apo diskutime?

Këshilltar E.Fejzullah: Për pyetje më lindi tani. Për punën e organizatave shoh këtu një pikë e cila thotë 10 vjet eksperiencë në fushën e turizmit dhe do doja të dija nëse ka ndonjë organizatë e cila ka shprehur interes për këtë gjë mbase këto kushte janë pak të tepruara sepse 10 vite eksperiencë janë shumë dhe nëse vendosim kushte të cilat do na shtyjnë afatet nuk do marrë njeri pjesë, pastaj do detyrohemi të ndryshojmë kushtet dhe ta zgjasim më shumë seç duhet këtë process.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për pjesën e bashkëfinancimit por miartojmë dhënien me huapërdorje, në rast se do ketë nevojë për bashkëfinancime të tjera do drejtohem përsëri në Këshill. Përsa i takon kriterëve, mos i merrni sit ë pandryshueshme, nëse keni ndonjë propozim për të ndryshuar diçka, na i thoni ta ndryshojmë.

Këshilltar K.Pllaha: Janë kritere përjashtuese apo janë thjesht për të mbledhur pikë?

Nëse janë kritere përjashtuese atëherë besoj përjashtohen shumë, nëse janë grumbullim pikësh tjetër gjë pastaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ka ndonjë kriter që është përjashtues?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kriteret përjashtuese janë kriteret ligjore, të tipit duhet të jetë i rregjistruar në tatimet, e të tjera. Pjesa tjetër janë kriteret e pikëzimit. Keni ndonjë propozim për ndonjë ndryshim?

Këshilltar L.Petri: Edhe unë e mbështes propozimin që bëri Eraldi sepse në këndvështrimin tim në Qarkun e Korçës nuk ka ndonjë OJF me 10 vite eksperiencë në fushën e turizmit. Tani kutpohet që kjo do thotë që nuk do marrë këto pikë por pikë të tjera por mendoj megjithatë janë vënë pak kritere të larguara nga realiteti ynë. Në parim unë e mbështes këtë nismë edhe madje jemi vonë duhej bërë 10 vite para kur filluam me fushën e turizmit, megjithatë të shërbejë si një mësim i nxjerrë dhe shpresojmë për një mbarëvajtje të saktë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është hera e tretë që e them këtë gjë mos flasim kështu në përgjithësi. Keni diçka konkrete përshembull kriteri x të bëhet kështu dhe jo ashtu, na thoni si ta ndryshojmë, ta dëgjojmë, në rast se ja u ha syri dhe këshilltarëve të tjera ta miratojmë. Përsa i përket shpejt apo vonë ju duhet ta dini që këto përpjekje i kam filluar shumë më shpejt për të përfshirë gjithë aktorët dhe kanë dëshirë të përfshihen dhe të japin një kontribut. Kam qënë unë iniciatori për të ngritur atë komitetin e zhvillimit të turizmit në Bashkinë e Korçës me përfaqësues biznesi, shoqëri civile, univeristet edhe bashki dhe nuk na ka munguar ne dëshira dhe vullneti, duhet gjithë aktorët ta kuptojnë rëndësinë dhe të japin një kontribut sepse nuk i detyroj dot të bëhen pjesë e kësaj përpjekje, patjetër duhet të ketë një lloj interesi dhe shenjat më duken positive. Në rast se dikush thotë do bëhem pjesë e komitetit pastaj thotë do dal ky nuk është faji i Bashkisë, derën e kam të hapur, mjafton të jenë përpjekje reale për të realizuar diçka në këtë drejtim.

Këshilltare A.Zheku: Duke përjashtuar bllokun e parë që juristia tha se janë të përjashtueshme, kaloj tek blloku i dytë porpozoi mos jetë pikëzimi në bllok, 4 kritere ka më poshtë dhe totali 10 pikë, t'i referohemi pikëzimit analiktik, kemi 4 pikë të katërta kanë barazim nga 2.5 pikë?

Kriteri i 4 thotë të ketë minimum 10 pikë, po nëse ka 1 vit përvojë a do ketë 1 pikë?

Do ngrihet një komision patjetër sipas materialit që thamë, referuar 4 kritereve që ka ky bllok, në total janë 10 pikë duhet t'i bjerë 2.5 pikë secilit kriter, ndërsa tek kategoria e tretë e kritereve kapaciteti financiar sërish nuk kemi një kapacitet të matshëm të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit. Do kemi dy që plotësojnë kapacitetet, nga 10 pikë që kanë 3 kriteret, 3.3 pikë secili kriter, ai tjetri nuk do marrë fare, ai që ka më tepër, duhet të jetë një kriter më i matshëm. Ai që ka më shumë merr 3.3, ai që ka më pak nuk merr fare? Nuk është e qartësuar, këtu le hapësirë interpretimi, pra komisioni do ta interpretojë dhe do ta pikëzojë sipas subjektit aplikues.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuka ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare A.Zheku: Parashikon, por pak më pak. Ky tjetri parashikon pak më pak, do i japësh 0, unë jam më tepër e matematikës dhe jam e shifrave.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: T'i marrim me rradhë, propozimi ynë është të pjestohet 10 për 4, pikët shpërndahen në mënyrë të barabartë nëpërmjet 4 kritereve dhe në rast se nuk ka numrin e viteve bëhet me rregull 3-shi. Tani pyetja në rast se ka 1/10, 1/10 e 2.5 sa do marr?

0.25, e njëjta gjë dhe për kriterin financiar, kush ve më shumë merr më shumë fonde merr maksimumiin, kush ve më pak merr me rregull 3-shi. Ka diçka, që duhet të ndryshojmë?

Jo, mund ta ndryshojmë nëse ka diçka, ai propozim është.

Këshilltar L.Petri: Doja një sqarim për vendndodhjen e objektit, pra është tek kulla?

Po.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Atëherë, hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 24 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Pika 14 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E DISA VLERËSIMEVE, QË MUND TË JEPEN NGA KRYETARI I BASHKISË KORÇË”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse komisioni i ligjeve nuk është mbledhur edhe njëherë një shpjegim nga ekzekutivi për sqarim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nëpërmjet këtij materiali, propozoj që Këshilli të miratojë disa propozime për vlerësim të cilat jepen pastaj nga ana e kryetarit të Bashkisë, personaliteteve, individëve të ndryshëm. Është propozim që mbështet në ligj dhe na ka lindur si nevojë nga kërkesat e ndryshme për të bërë vlerësime për individë të caktuar, aq më tepër ky propozim është i rëndësishëm ku me ndryshime e fundit që i është bërë ligjit, nuk është plotësuar me aktet nënligjore për periudhë të gjatë kohe kjo është arsyeja pse nuk kemi proceduar me propozime për dhënie tituli qytetar nderi. Ka edhe individë që meritojnë të vlerësohen mbase jo me titullin qytetar nderi por me vlerësime të tjera, ju ppropozoj t'i miratoni këto propozime dhe pastaj nga ana e kryetarit të realizohet vlerësimi dhe dhënie e certifikatave me vlerësimet.

Këshilltare A.Përmeti: Unë jam dakort përse i përket propozimit që sjell një frymë ndryshe apo vlerësim për ata të cilët janë të shumtë që kontribuojnë për Korçën. A kemi ne një rregjistër elektronik të gjithë titujve që Bashkia ka dhënë apo do jape dhe a e kemi atë të publikuar që të kenë akses gjithë qytetarët dhe nëse jo a mendohet a të ketë diçka të tillë në të ardhmen?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Çdo vendim Këshilli që ka dhënë për tituj nderi, e kemi mbajtur në një database që i është kaluar sekretares të Këshillit, deri në 2024 e kemi plotësuar nga drejtorja juridike.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk është dhënë më pas 2024.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Që nga momenti që ne dispononim vendime në arkivë diku tek 2007, pas 2024 nuk janë dhënë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Qëndron kjo pyetje e Adës dhe është një gjë duhet ta bëjmë dhe duhet t'i kemi të listuara që mos bëhemi gabim në sensin që t'i japim dy herë por edhe të përpiqemi t'i gjejmë nga arkiva.

Këshilltari A.Përmeti: Brezat e rinj sepse na pyesin shumë herë dhe ne nuk dimë.

Këshilltari L.Petri: Edhe unë e mbështes si iniciativë edhe ju uroj suksese!

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, atëherë e hedhim në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 15 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “STIMULIM I ARTIZANËVE” DHE PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË PAZARIN KORÇËS.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kryetari një informacion.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Dhe ky relacion është shumë i rëndësishëm dhe më vjen mirë që po vjen me këtë propozim në Këshillin e Bashkisë për të mbështetur një projekt i cili synon mbështetjen e një grupi individësh në fushën e artizanatit dhe në fushën për të zgjeruar pak këtë industrinë kreative në Pazarin e Vjetër të Korçës. Bashkia do marrë me qera një grup ambientesh, Pazarin e Vjetër të Korçës pasi të gjitha ambientet atje janë objekte private, pastaj nëpërmjet një procedure do ju jepen individëve që operojnë në fushën e artizanatit, industrisë kreative për të ushtruar tek këto ambiente aktivitetin e tyre. Ky është një projekt i rëndësishëm sepse ka 3 përfitime. I pari është që ju japim një ndihmesë këtyre individëve që të mbajnë gjallë traditën e artizanatit, e dyta japim një kontribut në rivitalizimin e Pazarit dhe së treti këta artizanë jo vetëm do ushtrorjnë aktivitetin e tyre tek këto ambiente por do jenë pjesë e një turi të vizitueshëm nga ana e vizitorëve vendas dhe të huaj do kenë mundësi të shohin procesin sesi ky product është prodhuar edhe të ndërveprojnë, të kenë mundësi të blenë produktin final. Krahas mbështetjes të këtyre artizanëve të krijojmë një produkt të ri, jo thjesht shfaqje të produktit final por shfaqje të gjithë procesit të punës. Është një projekt shumë interesant, turizmi i eksperiencës është një nga gjërat që na mungojnë dhe janë kërkesë nga ana e vizitorëve. Më vjen mirë që me mbështetjen e Këshillit të Qarkut, me financimin e këtij projekti do realizojmë me fondet e Këshillit të Qarkut, me këtë projekt do hedhim hapat e para të turizmit të eksperiencës. Më vonë në bashkëpunim me Fondin

Shqiptar të Zhvillimit do kemi një projekt e cila quhet Rrugët e Shijes në 4 fshatra do investohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në krijim të strukturave ku komunitetet e zonës do kenë mundësi të prodhojnë produkte tipike, tërhanin, petkat, dronkat, raki mani, produkte të bulmetit dhe peshkut, jo vetëm do , prodhojnë standart këto produkte por do jenë pjesë e një tur, turi i Rrugëve të Shijes, projekti është shumë i rëndësishëm në 3 komponentët e tij. Dua ta shoh të realizohet sa më shpejt kështu që ju ftoj ta miratonii relacionin, nëpërmjet të cilit ne miratojmë kriteret për të përzgjedhur një organizatë e cila do bëhet pjesë e Bashkive në menaxhimin e këtij projekti. Me relacionin në fjalë ne miratojmë kriteret për përzgjedhjen e organizatës dhe pastaj do jetë organizata e cila do përzgjedhë artizanët, të individëve në fushën e industrisë kreative që do vendosen në këto objekte dhe pastaj fuqëzimin e këtyre individëve për të marrë më të mirën e mundshme që do sigurojmë në mbështetje të këtij projekti. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltare A.Zheku: A ka të përcaktuar një periudhë kohore sepse nuk nuk shoh për sa kohë do jetë aktive, do jetë një-vjeçare e do rinovohet çdo vit apo 3, 5?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Marrëveshja me shoqatën, ndërsa kontrata e qerasë do bëhet 1-vjeçare.

Këshilltar L.Petri: Pse është fokusuar vëmendja vetëm tek Pazari i Korçës dhe a u shqyrtua mundësia që të kishim një policentrizëm sepse siç ka në urbanistikë të ketë edhe policentrizëm kulturor, a është menduar të ketë edhe zona të tjera mbështetëse të ketij projekti që mesa duket jo por po ju pyes pse jo?

Pyetja tjetër lidhet me targetgrupin dhe e kuptoj që këtu targetgrupi është artizanati dhe personat që janë marrë me këtë dhe e kanë trashëguar, a është qasur Bashkia drejtpërdrejt tek artizanati me mbështetjen dhe pse po vendos sot që nëpërmjet një shoqate tu vijë në ndihmë?

Këshilltare A.Përmeti: Në lidhje me materialin do doja që dy pikat që u sqaruan me afatin 2-vjeçar të shtohen në material. E shoh këtë iniciativë të nevojshme për Korçën sepse do e bëjë atë më konkurrese me qytete të ngjashme duke e sjellë si produkt turistik dhe mendoj se Pazari është zona e duhur për t'i dhënë një fokus tjetër. Gjithashtu dua të di sa është numri i artizanëve dhe ata që merren me industri kreative që do mbështeten, ka ndonjë numër të limituar apo është e hapur?

Dua një sqarim sepse ju thoni që do mbështesim edhe ata që merren me industri kreative, ndërsa në material ju e keni kufizuar që ju bazoheni vetëm tek ligji për zejhtarinë në Republikën e Shqipërisë, nëse e bazojmë vetëm tek ligji e kufizojmë, sepse industria kreative është edhe me pjesën e startapeve dhe me bizneset e reja. Këto kisha, jam pro.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë, ju lutem respektoni rradhën, bëni pyetje pastaj komente.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po e filloj nga kjo e fundit, target do jenë individët që janë në fushën e industrive kreative dhe Anxhela duhet korrigjuar dhe artizanati është një nëngrup i industrive kreative. Ka një përcaktim se kush quhet industry kreative jo çdo startap quhet industry kreative por ka një listë, definicion, është artizanati brenda, pjesa e fotografisë, e videos dhe disa gjëra të tjera që janë të listuara. Fillimisht e filluam si një material për të mbështetur artizanatin, ndaj është edhe ai defekti në material, pastaj menduam ta zgjerojmë atë gamën duke përfshirë edhe pjesën e industrisë kreative të cilat lidhen me pjesën e artizanatit, mund të jetë një studio fotografie. Tani pse Pazari, jam i sigurt që nëse do ja u kisha sjellë pa destinacion dhe do ju thoja tani këtu në Këshill më jepni një destinacion 99.9 % do thonin tek zona e Pazarit sepse ka shumë arsye, e para Pazari i tillë ka qënë historikisht, ka qënë vendi i artizanëve dhe tregut i gjërave që shiteshin në atë kohë dhe konfigurimi i godinave është i tillë ta mundëson këtë gjë. Në rast se do ishte në vend tjetër ti do kishe vetëm avantazhin po e quaj të pasur një grup artizanësh, kurse në Pazari arrijmë të bëjmë një miks ndërmjet grupit të artizanëve dhe arkitekturës të objekteve. Vendosija e artizanëve në zonën e Pazarit ka qënë pjesë edhe e planit të menaxhimit të Pazarit që është hartuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për zhvillim, në momentin që ata mbështetën një pjesë të ndërhyrjes të Pazarit të Vjetër, unë mendoj se është vendi ideal dhe shqyr që e kemi. Përsa i përket pyetjes pse u kujtuat tani, është e vërtetë tani u kujtuam, nëse i keni kushtuar vëmendje paketës fiskale kur e kemi miratuar, do keni parë që ne i përjashtojmë artizanët nga pagesa e tarifës, për vitin e parë dhe kur janë gra edhe për vitin në vazhdim pra e kemi pasur ndjeshmërinë. Përsa i takon numrit, synojmë që ky numër të jetë në varësi të qirave që do negociojmë ne, por me një llogari që kemi bërë 8-10 individë fillimisht. Ndërkohë që nëse projekti ecën ashtu siç unë e kam menduar, me sukses do kemi mundësi të ngrejmë edhe fonde të tjera nga buxheti i Bashkisë që projektin ta zgjerojmë edhe me një numër më të madh artizanësh, këto ishin pak a shumë ato që mbajta shënim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka komente?

Këshilltar L.Petri: E falenderoj z.kryetar për këtë parantezë që bëri, ne e mirëpresim turizmin e eksperiencës dhe ky është rasti një nga ato raste. Projekti është shumë i bukur ndërkohë unë e kam me autoritetin, kush po e jep këtë projekt, spse u përmend këtu Pazari dhe a thua që do bëhej një studim që njerëzit do ishin 99 % do thoshin po, ndërkohë që nuk është e vërtetë, perceptimi i njerzve nuk është kështu. Më thoni ju lutem si mundet një artizan që ka investuar djersën, gjakun të gjitha merr shmbull Vasil Kolevicën dhe është tani aktor për turizmin, i themi me një mendësi komuniste, lerë vendin atje dhe hajde këtu në Pazari se duam ne, njësoj siç merreshin mësuesit dhe doktorët në fshat dhe jo tanasjelltas të shkonte pacienti në spital. Më thoni ju lutem, si mundet që të themi se ne i kemi mbështetur duke zeruar paketën fiskale për 1 vit, kur e dimë që artizani është njeriu që punon në të zezë, kur është njeriu që mbështetjen e do atje ku është dhe nuk është nevoja t'ja ndryshosh venndndodhjen dhe pse duhet që nëpërmjet një shoqate apo pale të tretë ta kapim për veshi si polici. Mund të shkojmë drejt për së drejti tek vendet ku ata janë të hartëzohet një hartë dixhitale se ku janë artizanët ekzistues dhe të mbështeten ashtu. Për ta mbylluar projekti është shumë i bukur po mjerisht po e them që paraqitet me hipokrizi sepse edhe tek Pazari e pamë fare

mirë si u dhanë mbështetjet me miq e shokë siç ja u kishte interesi, kam përshtypje që kriteri moral i juaj le për të dëshiruar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ky është mendimi juaj, z.kryetar para se t'ja u jap fjalën ka znj.Alekta diçka.

Këshilltare A.Zheku: Më duket e tepër kjo structure ndërmjetëse për të përzgjedhur 8 ose 10 artizanë, structure e cila do shtojë kostot dhe mendoj se strukturat e Bashkisë janë tepër të mjaftueshme për të bërë përzgjedhjen e 8 artizanëve. Këtu në një nga pikat e materialit thuhet kreativitet në të gjitha format, le një hapësirë shumë të gjërë, ndërkohë që poshtë citohet ligji për artizanët sesi i përcakton ky ligj apo diçka tjetër të bazuar ku do e kemi këtë kreativitet të gjitha formave, apo një kategorizim kush do ketë të drejtë të aplikojë, duhet pak më e ngushtë besoj se kreativitet i gjitha formave ka shumë, të ketë një kornizë më të ngushtë për t'i dhënë të drejtë të aplikojnë dhe të zgjerohet kjo pjesa ligjore.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani në lidhje me atë akuzën që po i marrim artizanët me detyrim, nuk po marrim askënd me detyrim, artizanëve do ju bëhet një ftesë kush do të marrë pjesë, do plotësojë kriteret dhe do aplikojë, kush nuk do nuk do aplikojë nuk do marrim njeri me zor, e kam thënë vazhdimisht nëpër mbledhjet i kontrolli ato që thoni apo siç ju vjen ndërmend i thoni. Tani në lidhje me hipokrizinë desinicioni i hipokrizisë, që po ju qajmë hallin kot këtyre artizanëve. Unë mendoj se ky projekt nuk është hipokrizi por një mbështetje konkrete për artizanët, për të dhënë një kontribut për rivitalizimin e Pazarit të Korçës dhe për t'i shtuar Bashkisë një kontribut turistik. Hipokrizi do ishte nëse unë do bëja një fjalim për artizanët pa ndonjë projekt nga mbrapa, e kundërta unë po ju sjell një projekt dhe po ju kërkoj ta mbështesni . Përsa i përket banaliteteve që mbështetja në rivitalizimin e Pazarit u bë me miq e me shokë nëse ke diçka konkrete muhabete kafeneje të kam thënë disa herë nuk muhabete kafeneje nuk mund t'i zbrazësh ne mbledhjet e Këshillit, nuk është Këshilli ambient çfarë dëgjon në kafene ta zbrazësh këtu. Përsa i përket përfshirjes të një organizata vjen e njëjta logjikë si menaxhimi i zyrës të informacionit turistik dhe përfshirja e kësaj organizate nuk ka një kosto shtese dhe projekti ka ana financiare do mbështet me fonde publike nga Këshilli i Qarkut, do mbështetë vetëm marrjen me qera të objekteve. Pjesa tjetër detyrime elektrike, ujë e kanë vetë artizanët, shoqata nuk do marrë ndonjë lekë nga fondet publike, në të kundërt do ketë detyrë pasi të përzgjedhë artizanët me buxhetet e saj të mbulojë për t'i fuqizuar këta artizanë, për ta përmirësuar mënyrën si funksionojnë edhe në funksion të këtij komponentit turistik.

Këshilltare A.Zheku: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon). Të marrjes me qera të ambienteve dhe do paguajë shpenzime operatore, energji elektrike, ujë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të lihet ajo pike siç është për të krijuar mundësinë se mbase më vonë do ja u mbështesim edhe këto, ideja është që ne do mbështetim vetëm pjesën e qirasë dhe kjo mbështetje mendimi im duhet të jetë në trajtën të shkallëzuar rënëse, vitet e para t'i mbështesim 100 % më pas kjo të jetë rënëse derisa ata të fuqizohen dhe të funksionojnë vetë.

Këshilltare A.Zheku: A do ketë shumë të barabartë qeraja apo do jetë e ndryshme në varësi të ambientit?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në pjesën e vendimit është në rregull mbështetimi vetëm qeranë, në pjesën e realcionit mbase ka shpëtuar kjo, do mbështetimi vetëm qera. Qeraja nuk do jetë një lloj sepse një objekt mund të jetë më i madh, një më i vogël, më i mirë në gjendje, një më keq, ato do negocohen do jenë pjesë e procedurës që do bëjë Bashkia.

Këshilltar A.Përmeti: Në këtë kuadër do ishte mirë t'i mbështesim mbase energji dhe ujë jo se varet sa harxhon secili, po të rehabilitohet ky dyqan për të kthyer në artizanat sepse nëse është një dyqan që është bërë për shpenzime investimi dhe kjo mendoj unë që këtu e ndihmojmë ata.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe kjo vërtetë qëndron, ne do përpiqemi të marrim objekte që nuk kanë nevojë për investim. Në rast se do ketë nevojë për investime do jetë një prej detyrimeve të organizatës që të ngrejë fondet e saj ose të kërkojë që të aplikojë që të sigurojë këto mini investime për të realizuar përshtatjen. E kemi parë donim ta përfshinim në projekt kishim vështirësi ligjore dhe e kemi lënë, mendojmë t'ja lemë organizatës.

Këshilltar K.Pllaha: Opinioni im është pozitiv lidhur me këtë projekt sidomos në pjesën që do mbështeten artizanët edhe për ndikimin e tyre në turizëm, por kjo mbështetje është vetëm për ata që pranojnë të vijnë në Pazar sepse atyre të tjerëve nuk po ju subvencionohet aspak qeraja, është një lloj pa barazie dhe mua më duket një lloj serumi për të mbajtu gjallë Pazarin dhe e drejtë sepse është një investim i madh, por për mendim tim do ishte më favorizuese nëse mbulonim gjithë artizanët me 50 % sesa këta që vijnë në Pazar 100 % ata të tjerët 0 nuk është e drejtë. Nga aspekti turistik nuk ka ndonjë efekt turistik të jenë gjithë artizanët të grumbulluar në një zonë të caktuar, kur janë të shpërndarë është më bukur përshembull kur ikën nëpër rrugica ti ndeshesh me një zonë që punon me një vegël apo një këpucar, janë zbulimet e xhevahireve në ato rrugicat tona karakteristike, ky është opinion im.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush diçka?

Këshilltar L.Petri: Sygjeroj që ekzekutivi i Bashkisë t'i ketë zyrat tek Pazarin dhe ta shpallë që këtu është Bashkia Korçë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: I ftoj këshilltarët ta hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 2

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 21 pro, 1 kundër, 2 abstenim.

Pika 16 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E SIMBOLIT “KORÇA EUROPEAN CITY OF SPORT” NË KUADËR TË MARRJES SË TITULLIT “KORÇA QYTETI EUROPIAN I SPORTIT 2026.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nga ekzekutivi një sqarim, bëhet fjalë që pas logove që përdoren tani në gjitha shkresat zyrate të përdoret edhe logoja Qyteti European i Sportit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush diçka?

Pra po miratojmë vendosjen e kësaj logoje krahas logove të tjera në shkresat zyrtare.

Këshilltar L.Petri: Pse po bëhet kjo?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse të duket e pa vlerë mund të bësh një koment. Kështu që nuk ka nevojë për të bërë pyetje të tilla retorike. Nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët e hedhim në votim, kush është dakort?

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare, bëra një pyetje e nuk mora përgjigje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar L.Petri: Unë bëra një pyetje dhe nuk mora përgjigje, kolegët donin të bënin komente dhe nuk i latë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Të lutem mos e bëj këtë lloj komenti, ti të paktën sepse jam shumë e vëmendshme në kërkesat që bën secili nga ju apo kur ju adresohem për pyetje, apo për komente ta dhashë fjalën, nëse ju kujtoheni dhe ata duan të bëjnë politikë me fjalët tuaj retorike që ja dini dhe përgjigjen, dakort mbështetini, por nuk është e vërtetë dhe nuk e kam bërë në asnjë rast, ju kam kërkuar të jepni mendimin tuaj dhe vëmendja ime ka qënë gjithmonë këtej nga ju, vetëm dora juaj ka qënë. Atëherë do ju marr edhe të bëjmë kartona për ngritje dore.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare e kisha për kritikë në veçanti, e di që na keni respektuar dhe kundrejt ligjit na ke dhënë të drejtën e fjalës, mund ta bësh edhe në këtë pikë të lutem?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër anullova edhe procesin e votimit dhe po ju dëgjoj edhe njëherë. Kush nga këshilltarët ka pyetje tjetër ndryshe nga z.Petri?

Këshilltare M.Qeleshi: Pyetje sqaruese për logon më shumë, flaka olimpike e ky ylli me 5 cepa edhe 2467 yjet, ndoshta mund të jemi pak injorantë në perceptimin e logos, por më shumë e kam tek ky ylli i madh me 5 cepa, çfarë përfaqëson?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E dha përgjigjen kryetari, nuk është ajo që mendoni ju.

Këshilltare M.Qeleshi: Mund të thuhet çfarë është sepse kryetari nuk e di çfarë mendoj unë, ka disa variante për yllin me 5 cepa. Në rastin konkret kjo që po miratojmë sot, vërtet është gjë shumë e mirë kjo Korça Qyteti European i Sportit, madje këto 7 yjet mund të jenë edhe 7 njësitë administrative të Korçës përshembull, mund të ketë pasur edhe variante të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër nga këshilltarët apo të dëgjojmë përgjigjen?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica:Logoja është idejuar nga stafi i Bashkisë, nga personat që merren me dizajnin, kreativitetin. Përsa i përket yllit nga shpjegimi që është dhënë nga grupi i

punës përkatësinë ndaj vlerave Europiane, unitetin, bashkëpunimin dhe krijon bazën strukturore të logos duke i dhënë stabilitet dhe qartësi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E themi edhe në gjuhën popullore, emri kapistall është mos u merrni me logon pasi ajo një element indetifikues i dizajnit, e rëndësishme është fakti që në 2026 Korça do jet Qyteti European i Sportit dhe do indetifikojë aktivitetin që do jetë në kuadrin e këtij viti të veçantë për bashkinë ku ne propozojmë të vendoset në shkresat zyrtare. Këtë vit do ketë një calendar të pasur me aktivitete sportive jo vetëm sporte kopetitiv por edhe sportin për të moshuarit, sportin si element edukimi për nxënësit. Tani me logon do merremi, nuk e kam nga ana e seriozitetit, patjetër duhet, por po them mos u merr me dizajnin e logos as ti, as unë sepse nuk jemi profesionistë të dizajnit.

Këshilltari M.Qelesi: Thjesht doja një pyetje sqaruese, çfarë simbolizojnë këto gjëra. E dyta çështja e emrit kapistall, patjetër mund të jetë por në rastin konkret të vesh një logo ku do vesh gjithë dokumentacionin, nuk është çështje emri kapistall por çështje serioziteti të çdo lloj dokumentacioni, kështu që emri kapistall nuk është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Rëndësia nuk qëndron tek qëndron tek rrathët olimpik apo diçka tjetër por është tek rëndësia që Korça do jetë Qyteti European i Sportit, hajde diskutojmë lidhur me këtë gjë çfarë do bëjmë. Unë kështu e shoh që është dizenuar nga stafi i Bashkisë, ka një shpjegim do të na indetifikojë në aktivitetet që do bëhen në kuadrin e këtij kalendari, aktivitete sportive dhe do jetë pjesë e shkresave të Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka kërkuar z.Petri, pastaj z.Bregu fjalën.

Këshilltar L.Petri: Kam një sygjërim para se kjo të afishohet tek çdo dokument zyrtar të paktën të shkruhet sipas shqipes drejtshkrimore dhe në shqip nuk shkruajmë european por evropian, faleminderit.

Këshilltar E.Bregu: Tani nga logoja që shohim këtu nuk kuptojmë asgjë të ketë lidhje me sportin, këto shpjegime që na dhanë nga ekzekutivi ishin disa shpjegime standarte që nuk kanë lidhje me çështjen konkrete. E dyta nuk dua të merrem me komentin emër kapistall sepse ishte shumë e gabuar nga ana e kryetarit, sepse logoja përcakton disa të dhëna që i jep perceptimin njerëzve dhe është nderi në këtë rast dhe halli tonë me këto yjet është nesër nëse bëhet një analizë mos turpërohet Bashkia, kryetari e zgjedh vetë se çfarë bën.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po Evropa me yje e ka flamurin.

Këshilltar E.Bregu: Logoja është shumë e rëndësishme, mendoj se duhet të rishikohet, ndaj i ftoj këshilltarët ta mendojnë më thellë çështjen e logos dhe të vijë përsëri.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, edhe me atë pjesën e korektimit siç e tha dhe z.Petri unë jam dakort. Hapim procesin e votimi, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 21 pro, 4 kundër, 0 abstenim.

Pika 17 e rendit të ditës.

SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “KORÇA 2008 ” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 “TË KORÇA 2008” SH.A.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Tollkuçi.

Këshilltar P.Tollkuçi: Përhëndetje të nderuar këshilltar, të nderuar kolegë, në emër të grupit tonë propozoj të jenë ata që kanë qënë, znj.Anila Çunoti dhe znj.Ilda Ikonomi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka prpozime të tjera, nëse jo i hedhim në votim për të dyja zonjat. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 18 e rendit të ditës.

SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË “SKËNDERBEU” PËR VITIN 2026.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: I marr 1 nga 1, ju lutem komisioni në lidhje me pikën e parë.

Këshilltare A.Përmeti: Materiali që ka erdhur është i njëjtë me atë të vitit të kaluar, pra nuk ka ndryshime për vlerën për person dhe periudhën që mbulohet dhe është e njëjta vlerë, e cila është e parashikuar në buxhet, me buxhetin që ka sjellë vetë SHA-ja, e kaloj për votim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh faktin që Bashkia Korçë është aksionere tek ekipi i futbollit Skënderbeut, kryetari ka kërkuar informacionin për të cilin kemi diskutuar shumë here nga aksioneri maxhoritar, ndaj është momenti të pyesim nëse ka erdhur përgjigjia nga aksioneri maxhoritar apo jo?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo pyetje që ju bëni është jashtë rendit të ditës, nëse ka diçka nga këshilltarët lidhur me këtë çështje?

Këshilltar E.Bregu: Po si nuk ka lidhje, është trajtimi ushqimor tek kjo akademi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju e thatë, nuk bëtë vetëm pyetje por edhe komente.

Këshilltar E.Bregu: Komentet bëhen që të kuptohet pyetja, nuk ka asgjë të gabuar, e gabuar është kompetenca që po merrni ju, do e japim në të ndryshme. Nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 23 pro, 2 kundër, 0 abstenim.

- PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Propozime ju lutem.

Këshilltar P.Tollkuçi: Edhe tek kjo pikë propozojmë qëndrimin e audituesve paraardhës, znj.Anila Çunoti dhe znj.Ilda Ikonomi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër nga këshilltarët e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Gjatë monitorimit të votimit së bashku me Janin që është djali që na ndihmon, kërkojmë të bëhet një rivotim i pikës 2.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Gabimisht është ulur një këshilltar në emrin e një këshilltari tjetër dhe del emri i atij këshilltari.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E hedhim dhe njëherë në votim procesverbalin e mbledhjes?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kanë erdhur dy kërkesa.

Këshilltar A.Përmeti: Kam unë diçka.

Këshilltar K.Pllaha: Për procedurë, para se të kalojmë në kërkesa-ankesa, kemi pika të ndryshme.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo se nuk do ju jepja fjalën por ka qytetarë që kanë erdhur që në fillim të mbledhjes dhe t'i respektojmë, t'i dëgjojmë se vajti vonë dhe thash këtë gjë. Znj.Përmeti çfarë kishit?

Këshilltare A.Përmeti: Pavarsisht se nuk është pikë për diskutim , raporti i performancës është shumë i rëndësishëm dhe unë dua të them dy gjëra dhe mbase të marr edhe përgjigje për një pyetje që kam.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mund jetë edhe për financën dhe drejtoreshën e financës nuk e kemi.

Këshilltar A.Përmeti: Jo është për kryetarin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kryetarin këtu e kemi. Një kërkesë që ka erdhur nga administratori i njësisë Voskopojë, gjatë ushtrimit të funksioneve të mia si administrator, në njësitë administrative Voskopojë ka realizuar procesin e përcaktimit të ndarjeve të lagjeve në fshatin tonë, kry proces është kryer në një proces konsultimi drejt për drejt me banorët si dhe duke u mbështetur në hartografinë dhe dokumentet historike të Voskopojës. Ky email i është drejtuar sekretarisë, mua, kryetarit dhe drejtorisë të urbanistikës me drejtorin e urbanistikës menduam se ajo ka nevojë edhe njëherë për të bërë një projekt në lidhje me këtë gjë është diskutohet teknikisht nga drejtorja e urbanistikë dhe më pas do informohen edhe kërkuessit. Ka një kërkesë të dytë që vjen drejtuar Këshillit të Bashkisë, kryetarit të Bashkisë në dijenin time kërkuessi është prezent z.Agron Elezi po citoj atë që ai ka shkruar dhe nëse ka diçka pastaj mund ta thotë edhe vetë. Jam Agron Elezi me profesion mësuaes dhe gazetar i pa varur ju si Këshill Bashkiak po edhe si Bashki keni

shumë probleme për të zgjidhur por duke besuar në ndërgjegjen, humanizmin tuaj për të mbështetur artin po ju parashtrij një kërkesë. I nderuar unë kam gati për botim një libër historik Historia e Ish-komunës Mollaj nga rrënja deri tek gjurmët e trashëgimisë nga fshatrat Dvoran, Kamenicë, Floq, Bellovodë, Pulah, qëndër komunë, ka mbi 10 vjet që punohet dhe duke menduar që është pjekur për ta futur në furrën e botimit. Duke menduar parë dhe gjykuar se kam dhënë një kontribut modest mbi artin poet, shkrimtar, gazetar, sportiste për dhjetra dekada mbi figurat patriotike atdhetare që nga Kristo Floqi, është shkruar mbi luftën për ata që dhanë jetën, partizanë, dëshmorë dhe për shkatërrimin e shtetit Shqiptar në 1970 dhe ardhjen e Kosovareve në 1999, është shkruar edhe për folklorin, vallet por kam hasur vështirësi financiare pasi libri ka 500 faqe dhe foto me ngjyra që rritin kostot e botimit të tij. Një foto vete rreth 15 mijë lekë të vjetra, 50 % do i paguaj vetë, ju me të drejtë do thoni pse nuk financojnë biznesmenët e zonës por nuk ju kam kërkuar nga frika se kam frikë se do nxi faqen. Do ju isha mirënjohëse nëse ju do aprovoni një kosto modeste për botimin e librit, për të mos e zgjatur po ju lë një parakopje të librit dhe një dvd me librin, faleminderit dhe festa të mbara është dërguar në fund të dhjetorit. Unë kam bërë një bisedë me z.Elezi pasi e njoh duke e sqaruar me mendimin tim personal pasi do dëgjojmë edhe mendimin e këshilltarëve dhe është e pamundur që Bashkia të mbështesë botimin e librit pasi është e drejta e vetë autorit sepse të ishte kështu të gjithë shkruanim nga një libër edhe të vijmë të kërkojmë mbështetje financiare. Do ja jap fjalën kryetarit më pas z.Elezi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E vlerësoj shumë këtë punë, përpjekje z.Elezi për të shprehur historinë tek një libër, porblemi qëndron se kemi pasur këkresa edhe më parë dhe kemi diskutuar edhe në brendësi edhe me grupet e auditimit të KLSH-së dhe është e pamundur ligjërisht të mbështesim financiarisht botime të librave sepse konsiderohen sponsorizime dhe ne e kemi të ndaluar me ligj. Ne kemi pasur dhe raste të tjera dhe është e pamundur t'i bëjmë, nuk është çështje vendimmarrje Këshilli, nuk e mbështesim dot dhe kjo është për gjitha rastet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Elezi fjala për ju.

Qyetar: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë nuk thashë që kemi probleme morale, thashë kemi problem ligjor se kemi pasur këkresa edhe më parë dhe kemi diskutuar edhe në brendësi dhe është e pamundur ligjërisht të mbështesim financiarisht botime. Unë nuk thashë nuk mbështesim këtë libër dhe mbështesim të tjerë sepse e kemi të ndaluar ligjërisht, sesi është kuadri ligjor në Maqedoni unë nuk e di, unë di atë të Shqipërisë dhe atë zbatojmë ne, nuk miratohet me vendim Këshilli, është kuadër ligjor që është miratuar sipër nesh dhe jemi të detyruar ta zbatojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z. Bregu ja u jap fjalën më pas, e ka fjalën z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Unë e përgëzoj z.Elezi e kuptoj edhe z.kryetar që thotë se kështu është baza ligjore dhe nuk ke mundësi ta alokosh këtë fond drejt për së drejti, si kundër nuk mund ta pranoj si anëtar Këshilli që nuk ka mënyrë tjetër të mbështetet zotëria. Fjala vjen na u përmend edhe sotnga z.kryetar në kuadrin e turizmit, Rugët e Shijes fare mirë mund të lihet një zë edhe për turizmin kulturor. Njeriu vjen ushqehet, takon njerëz por edhe mëson për traditën dhe kulturën, për autorët dhe në këtë mënyrë, e kam sygjerrim këtë sepse sigurisht ne duhet të jemi të kujdeshëm dhe në krijimin e precedentëve por në rastin në fjalë mesa kuptoj i kërkoj ndjesë zotërisë sepse nuk ja

kam lexuar librin por mendoj se është një punë kolosale që nderon të gjithëve, Bashkinë edhe historinë tonë, nuk them që t'i japim lugën bosh zotërisë, t'i them që do e mbështetim dhe nga ana tjetër jo, por jam i sigurt që me intuitën time modeste që ka mundësira si mund të mbështeten.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z. Bregu më pas znj. Ada.

Këshilltar E. Bregu: Në lidhje me çështjen mendoj se Bashkia Korçë dhe ekzekutivi duhet të sjellë një relacion pasi strukturat e Bashkisë ta studiojnë mirë propozimin e zotërisë, duke pasur parasysh çfarë botimi është dhe mos japim përgjigje të thjeshtë ne nuk financojmë libra sepse duke u nisur nga kjo nuk ishte pse të vinte propozimi deri në Këshill por ishte ndërprerë që në kërkesa.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Sesi përgjigjet është tjetër gjë.

Këshilltar E. Bregu: Duhet bërë një analizë propozimi, që ky propozim që ka sjellë kjo kërkesë është vetëm për librin apo mund të kanalizohet në projekte të tjera, nuk e kanalizojmë ne si Këshill por Bashkia. Duhet një relacion nga strukturat kompetente, e kanë anaizuar nga ana ligjore duke e marrë shabllon është kërkesë për libër pa e parë fare, kjo është që unë them se është gabim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju thoni të silllet një relacion dhe t'i kthehet përgjigje z. Elezi.

Këshilltar E. Bregu: T'i silllet Këshillit, që kjo kërkesë është bërë për këtë gjë, që është një libër letrar, apo i shërben turizmit, apo sportit sepse Bashkia financon projekte të ndryshme nëse është i vlefshëm gjithmonë. Ky relacion na jep informacion nëse është i vlefshëm apo jo.

Këshilltare A. Përmeti: Unë e shoh këtë si sensibilitet e banorëve dhe gjithë qytetit dhe zonës përreth që i takon ky studim apo libër që vjen me histori, 100 mijë lekë të reja nuk janë shumë dhe mund të mblidhen edhe me sensibilizim, ndoshta duke ju drejtuar edhe Fakultetit të Historisë që kemi ne për të bërë një fantrezi që mund të jetë ajo siç është ajo e nevojave shëndetësore mund të bëhet edhe në këtë rast sepse mund të ketë shumë që duan të mbështesin këtë gjë sepse ne nuk e kemi provuar, duhet ta provojmë dhe mund të mblidhet fondet me këtë ja jap si sygjërim zotërisë. Unë do kisha shumë dëshirë ta mbështesja nëpërmjet një instrumenti të caktuar.

Kryetari i Bashkisë S. Filo: Edhe njëherë mbështetje financiare për botimin e një libri ne nuk japim dot, e kemi të ezauruar para shumë vitesh, madje kemi pasur një eksperiencë negative para se të bëhesha kryetar Bashkia, ku Bashkia ka mbështetur botimin e një libri dhe ka erdhur KLSH-ja dhe na ka lënë si detyrë t'ju kërkojmë lekët, e kam ezauruar si problematikë dhe kemi qëndrim standart. Nga ana tjetër qëndrojnë këto sygjërimet, që zotëria mund të aplikojë në kuadrin e një projekti, bëhet një tip simbonziumi për historikun e zonës dhe në kuadrin e tij mbështeten këto publikimet mundet, por kështu të vijmë në Këshillin e Bashkisë dhe të mbështesim botimin e librit jo pavarësisht se kemi dëshirë, tjetër dëshira dhe ana ligjore. Nuk kemi fondet tona siç po thua ti më pëlqen do ta mbështet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Shkoj edhe disa qytetarë të tjerë, sapo ishin disa banorë të zonës tuaj atje, kemi folur me drejtorin e urbanistikës paraprakisht edhe njëherë ta dëgjojnë këshilltarët.

Qyetar: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Vjollca se këshilltarët nuk e dinë erdhën dy zonja më parë se të vinit ju u sqaruan me drejtorin e urbanistikës, i morën dhe numrin dhe do t'ju thotë ai. E dinte gjithë procedurën dhe sa më shpjet do ndërhyhet në zonën tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Vjollca të kam thënë duhet të vish të na kujtosh.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Morën përgjigje dy zonjat që ishin këtu sepse nuk është drejtori i urbanistikës për të dhënë një përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Meqënëse je këtu ngjitu lart kur të mbarojë mbledhja.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Pllaha në të ndryshme çfarë keni.

Këshilltar K.Pllaha: Kam një çështje që e jam njohur nga media dhe besoj se është me interes për gjithë qytetarët e Korçës, është bërë publike para dy ditësh në media që është aprovuar ndërtimi i një Parku Eolik në Bashkinë Korçë. Do doja të dija çfarë qëndrimi ka pasur Bashkia për këtë lloj investimi, a janë bërë konsultime publike me banorët e fshatrave në atë zonë, apo m grupet e interesit, operatorët turistikë meqënëse ne e kemi në vëmendje turizmin, duke përfshirë edhe turizmin malor. A është bërë një vlerësim i ndikimit në mjedis me këtë projekt i cili në dijeninë time duhet bërë për nivelin e zhurmave. Mbi të gjitha çfarë ndikimi ka ky projekt mbi çështjet turistike të zonës?

Ajo është shumë afër me Nikolicën, të cilën ju e keni promovuar si mundësi për ndërtimin e pistës të skive, premtimet tuaja të fushatës dhe mendoj se ndërtimi i Parkut Eolik do dëmtojë jo vetëm pamjen e zonës por edhe mundësinë për të zhvilluar turizmin. Ne kemi këtu një organizatë të Korça Alpin, keni bërë ndonjë konsultim publik me ta, çfarë ndikimi ka në turizmin malor, biodiversitetin e zonës atje?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush tjetër diçka nga këshilltarët për të diskutuar në të ndryshme?

Nëse jo po i jap fjalën kryetarit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo:Tani qëndrimi im si kryetar apo qytetar mendoj se energjitë e rinovueshme janë e ardhmja, e ardhmja e prodhimit të energjisë elektrike dhe ky është prioritet jo vetëm i Shqipërisë por edhe i BE ku ne duam të aderojmë. Një nga xhendat e BE-së është axhenda e gjelbër e cila parashikon që një hark kohor x, energjia që duhet të konsumohet nga BE të jetë nga burime të rinovueshme, siç janë dielli, era apo forma të tjera, meqënëse jeni më të updetuar për energjinë e rinovueshme dhe ambientaliste mund të jeni më të informuar edhe hidroja hyn në burimet e gjelbra të energjisë. Secili nga këto burime zbatohet në një teritor të caktuar, nuk ka asnjë për momentin që të ndodhë në mars dhe efektin ta japë në tokë. Hidroja do bëhet në lumenj, energjia solare do patjetër toka të vendosen panele fotovoltaike. Nuk po i shpikim ne këto Europa i ka me shumicë, nga vendet më të zhvilluara ato Nordike dhe deri në Ballkan ke projekte të shumta të energjive të rinovueshme dhe në rast do mbyllësh burimet fosile qymyrin, gazin do kalosh tek këto dhe këto duan vend, nuk mund të vendodësh energji të rinovueshme dhe mos pranosh të vendosësh turibina, sepse ku do e vendosësh këtë, kjo është në parim sepse e kam bezdi nga njëra ana flasim për energjinë e rinovueshme dhe pastaj ta shajmë. Çdolloj projekti me impact 0 nuk ka dhe këto i ka zgjedhur bota ka vendosur një balancë mes kostosh dhe përfitimit, një lloj impakti e

ka më të madh se 0, sesa ta vlerësojnë ekspertët. Unë si individ dua të mbështes energjinë e rinovueshme por duke zbatuar gjithë kuadrin ligjor në fuqi dhe tani po ja jap fjalën Anxhelës se çfarë praktike kemi përdorur dhe kuadrin ligjor që kemi përdorur, sepse unë mbështes projektet Brenda kuadrin ligjor dhe kam qënë shumë i kujdesshëm, kur më vinin aplikimet merrja vetë administratorët e njërive dhe kam thënë mos na sillni kot procesverbale të firmosur sa për procedurë se dua të di vërtet mendimin e banorëve. Banorët në disa raste që subjektet t'ju kërkojnë do ju japim dakortësinë por duam në shkëmbim një project komunitar, i mbështet projektet e energjisë të rinovueshme Brenda kuadrin ligjor, ky është qëndrimi im për projektet e rinovueshme. Disa fjalë fjalë Anxhela për projektin.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Aktualisht ne kemi një kontratë qeraja me subjektin që është lincësuar me vendim të Këshilit të Ministrave për ta ndërtuar këtë projektin, duke qënë se ka një mos përputhje të kuadrin ligjor për të marrë lejen e ndërtimit në Azht, ka një përplasje legjislacioni që të marrësh leje në AZHT duhet të lidhësh marrëdhënie me trualln, por që të lidhësh kontratën për të pasur marrëdhënie me truallin në Bashki duhet të marrësh leje nga AZHT, në këto kushte ne kemi bërë një kontratë qirjae duke i lenë subjektin në fjalë një afat 2-vjeçar për të plotësuar dokumentacionin që më pas të fillonte të hynte në fuqi kontrata e qerasë dhe të llogaritej detyrimi ndaj Bashkisë, jemi në këto kushte. Aktualisht ka plotësuar një pjesë të dokumentacionit që i duhet të hyjë në fuqi kontrata e qirasë, ka marrë VNM dhe VKM dhe është duke bërë procedurën për tu pajisur me leje ndërtimi, në mbledhjen e ardhshme do paraqesim një material ku do i jepnim edhe të drejtën që të përdorej një sipërfaqe trualli e Bashkisë dhe në këtë moment do të bëhej dhe dëgjesa publike. Nuk kemi në fuqi një kontratë në kuptimin e ligjit, është një kontratë që i duhet zotërisë në pjesën e dokumentacionit për të plotësuar para se të lidhim kontratën përfundimtare.

Këshilltar K.Pllaha: Një replikë të vogël, ju lutem mos hamendësoni nëse pyetjet e mia kanë apo jo tendencë, ato ishin pyetje për të sqaruar situatën edhe unë jam pro zhvillimit të energjisë të gjelbër por doja të dija këto pyetje që sqaroi znj.Dishnica dhe një pyetje, a interferon ky projekt me projektin e ski pistës të cilin ju e keni pasur prioritet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në dijeninë time nuk ka interferencë nëpërmjet tyre, përsa i takon impaktit mjedisor të tij, siç edhe u tha nga drejtoresha projekti ka marrë edhe VNM, është përgatitur një vlerësim nga specialistët e fushës edhe është miratuar edhe nga autoritetet e specializuara dhe i ngarkon edhe ligji me detyrimin për të shqyrtuar anën mjedisore të projekteve të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, z.Petri keni diçka?

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga drejtoresha nëse vlerësimi i ndikimit në mjedis e ka të përcaktuar edhe elementin e shpendëve shtegëtare sepse di rastin e Parkut të Prespës në të cilën është refuzuar një projekt i tillë sepse futet në rrugët jo korridorike që kalojnë pelikanët edhe shpendët e tjerë që janë në listen e kuqe të biodiversitetit. E dyta a ka përveç vlerësimit të ndikimit në mjedis vlerësim të ndikimit social sepse ato shkojnë paralel me njëra-tjetrën. Ju thoni se nuk është bërë konsultim ndërkohë që vlerësimi duhet të ketë vlerësim mjedisor dhe social. E treta e kam me z.kryetar i cili thotë nuk ka përplasje me projektin madhor të skive, nëqoftëse do realizohet përfytyroni veten si një skiator dhe në vend që të shikoni pisha të shikoni turbina kur fryn era dhe

prishin peisazhin. Në mendimin tim ka një përplasje unë jam pro energjisë të rinovueshme, vetëm se këto duan një studim të mirëfilltë, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ju e dini se ku është ky projekt?

Lere Klajdin, ku e di ti se ku është ky projekt, tani e dëgjove për herë të parë.

Këshilltar L.Petri: Po tani e dëgjova, nuk e kam dëgjuar nga media siç tha z.Pllaha.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë të dëgjova me shumë vëmendje, tani më dëgjo ti. Ti nuk e di fare se me çfarë distance është projekti nga zona e presupozuar se ku do zhvillohet projekti tjetër, të cilën as këtë nuk e di. Po flet për dy projekte që janë në dy pika që për hesapin tend ose njohurive të tua mund të jenë edhe 1 kilometërlarg njëra-tjetrës sepse ti nuk e di dhe duke mos e ditur po flet për skiatorët çfarë peisazhi do shohin. Mund të thuash mund të marr një informacion.

Këshilltar L.Petri: Prandaj jemi këtu të marrim informacion.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ti as e di fare, dëgjove një fjalë nga kolegu edhe u hodhe direkt me kokë Brenda dhe flet për skiatorët. E dyta drejtoresha dhe unë nuk jemi përgjegjës të studiojmë VNM me vëmendje, kur të jemi për aq sa do jemi do e japim opinionin tonë. Në rast se VNM kërkon në hartimin e tij edhe dëgjesat me publikun, patjetër nuk e di se nuk e njoh legjislacionin, në rast se e kërkon ligji është detyrim i subjektit dhe institucionit që e miraton që para se ta miratojë të bëjë check gjitha pikat. Përderisa e ka bërë unë mendoj se autoriteti që duhet ta mirtojë e ka kaluar këtë hallkë, ata që duhet t'i shqyrtojnë, t'i shqyrtojnë dhe të japin ok. Përderisa i përket dëgjesave që duhet të bëjmë ne, ajo është përgjegjësia dhe do i bëjmë ne.

Këshilltar K.Pllaha: Bashkia po bën konsultim publik sepse do japë një pjesë të territorit, por edhe sikur mos jepte territor çdo gjë që bëhet në territorin e Bashkisë mbahet përgjegjësi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Qëndrimi im është pro këtyre projekteve sa kohë plotësojnë detyrimet ligjore, nuk bihen ndesh me interesin e komunitetit dhe strategjinë tonë atje ku kemi sepse ka fusha ku Bashkia nuk ka strategji janë fusha më makro.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar të falenderoj për përgjigjen ehde e pranoj që bie me kokë Brenda për çështje të ndryshme dhe më lejo të kapem tek fjala jote që the se sigurisht ne jemi pro, po kur jeni pro si nuk keni mbajtur një qëndrim për Parkun Kombëtar “Bredhi i Drenovës” apo Bosdoveci kur ju hoq statusi nga Park kombëtar dhe pse duhet të të besojmë ne për këtë gjë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ku e dini ju që unë nuk kam mbajtur një qëndrim për të?

Këshilltar L.Petri: Na i thoni tani, unë kam bërë kërkesë vetë si qytetar për këtë dhe ja u keni pasuar zonave të mbrojtura prandaj e di.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal ku e dini ju që unë nuk kam mbajtur një qëndrim për të?

Po të pyes sepse e kundërta është e vërtet kemi mbajtur qëndrim me shkrim. Kemi mbajtur qëndrim dhe të mabjturit e qëndrim nuk mund të jetë gjithmonë kundër është edhe pro me disa meraqe si në rastin konkret dhe kemi thënë kur të bëhen këto planet e zhvillimit Bashkia duhet të jetë pjesë dhe komuniteti pjesë e grupeve të punës. E shikon që u hodhe dhe njëherë me kokë Brenda dhe the diçka të gabuar?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ada ka diçka.

Këshilltar A.Përmeti: Bëhet fjalë për raportin e performancës të vitit 2024 ndoshta është pak vonë sepse jemi në vitin 2025, për pjesën e raportit nuk e di cila është pjesa ligjore se kur duhet përgatitet ky raport. Gjithsesi e vlerësoj, ajo që unë lexova nga raporti ai është shumë profesionalisht i përgatitur sepse është mbështetur edhe nga Bashki të Forta dhe ndihmon ekzekutivin në vendimmarrje sepse ka të përcaktuar objektivat. Unë kam disa pyetje. A do vazhdojë të bëhet ky raport i analizës të performancës edhe kur mos kemi Bashki të Forta që mos na mbështesin>

Kush është struktura në Bashkia që e bën këtë?

Dua një saktësim që raport ndoshta duhet ta rregullojnë sepse kanë vendosur numrin e njërive 7 +1, tani 7+1 apo 7 +3?

Domethënë 3 rajone quhet 1 njësi, në menaxhimin e mbetjeve dhe pjesën e zjarrit kam diçka. Për menaxhimin e mbetjeve është vlerësuar maksimalisht performanca sepse kemi arritur 114.7 % të mbulimit të kostove nga ana e tarifave. Rekomandimi thotë se kemi vetëm menaxhimin e mbetjeve urbane, dua të di Bashkia çfarë plane ka për menaxhimin e mbetjeve të tjera, a do bëhet ndarja e mbetjeve dhe riciklimi i tyre sepse kjo sjell Bashkinë në nivel tjetër, në lagjet historike bëhet grumbullimi i këtyre kartonave, po mblidhet dhe nuk e di çfarë bëhet më tej?

Në rastin kur mbulohen këto kosto nga tarifat, a mendon që duhet të kemi një ulje të tarifave dhe kur ndodh kjo?

Mbase nuk ka ndodhur ndonjëherë por ne ndoshta jemi Bashki ndryshe, meqë kjo ka një tarifë që mbulon koston.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo ishte në formën e një informacioni.

Këshilltar A.Përmeti: Mirë unë po e bëj këtu. Pjesa tjetër lidhet për mbrojtjen nga zjarri ku kemi një ulje impakt të indikatorëve sepse duke qënë se kemi ulje të numrit të punojësve, por më shumë në mjete, aty është thënë kanë dalë mjete jashtë përdorimit siç i llogarisim për banorë. A kemi marrë ne mjet të ri për 2025, si është plani në vazhdim që mos ulet mbulimi por të na rritet për arsye sepse është me risk pjesa e menaxhimit të riskut.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përsa i takon uljes të numrit të mjeteve për popullsi nuk e di kujt i referohet sepse ne nuk na ka dalë ndonjë mjet jashtë përdorimit, numrin e punojësve nuk di. Përsa i takon mjetve ne jemi një nga Bashkitë më të mirë pajisura, një pjesë janë edhe të reja, një pjesë i kemi marrë të përdoruara por të viteve të fundit. I kemi shumë të mira mjetet, jemi relativisht të pajisur mirë në krahasim me Bashkitë e tjera. Sa i takon menaxhimit të mbetjeve, ka disa zhvillime pozitive, unë kam patur një takim para pak javësh me përfaqësues të agjencisë të mbetjeve edhe konsulentit që është angazhuar nga ana e agjencisë dhe do hartojë projekte zbatimi që do financohen nga banka Gjermane KFV dhe në kuadrin e kësaj mbështetje do bëhet mbyllja përfundimtare e fushës ekzistuese të mbetjeve në afërsi të Korçës. Do bëhet fillimisht projekti pastaj financimi nga KFV-ja i një ladhfilli i mbetjeve inerte, ju kam kërkuar të na bëjnë edhe një koncept të mbetjeve të gjelbërta, një zgjidhje si do veprojmë dhe pjesë e këtij do jetë ndarja dhe riciklimi të mbetjeve në Landfillin e Maliqit. Atje do ndërtohet një linjë dhe mbetjet që çojmë ne

si Bashki do kalojnë të veçohen, riciklohen dhe pjesa tjetër do depozitohet në Landill, kemi disa projekte që do e përmirësojnë situatën e menaxhimit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar, faleminderit këshilltarë. Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT

EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI